



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 15.07.2016

Ref.: 637/16

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.02/2013, datë 16.01.2013), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 43-të, të mbajtur më 06 Korrik 2016, mori:

V E N D I M

- I. Riakreditohen programet e studimit të Universitetit të Gjilanit “Kadri Zeka” për periudhën tre vjeçare, 1 tetor 2016 – 30 shtator 2019:
 - Parashkollor, BA, 240 ECTS, (maksimum 80 studentë për vit akademik);
 - Fillor, BA, 240 ECTS, (maksimum 120 studentë për vit akademik);
 - Juridik i Përgjithshëm, LLB, 240 ECTS, (maksimum 250 studentë për vit akademik);
 - Menaxhment, BA, 180 ECTS, (maksimum 200 studentë për vit akademik);
 - Shkenca Kompjuterike, BSc, 180 ECTS, (maksimum 75 studentë për vit akademik);
- II. Kuotat e caktuar më sipër për regjistrim e studentëve në programet e studimit, vlejné nga viti akademik 2017/2018.
- III. Obligohet Universiteti i Gjilanit “Kadri Zeka” që deri me 1 tetor 2016 në Agjencinë e Kosovës për Akreditim ta dorëzoj planin e rekrutimit të stafit akademik, për vitin akademik 2016/2017, për arsyeje të pensionimit të mundshëm te stafit, apo për çfarëdo arsyeje tjetër.
- IV. Obligohet Universiteti i Gjilanit “Kadri Zeka” që deri më 1 tetor 2016 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna në raportin final të ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit.

Arsyetimi

1/3

Universiteti i Gjilanit “Kadri Zeka” ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), për riakreditim të programeve të studimit me stafin akademik si në vijim:

Nr.	Programi i studimit	Niveli	ECTS	Bartësit e Programit
1	Parashkollor	BA	240	Januz Dervodeli, Merxhan Avdyli, Shpresë Qamili
2	Fillor	BA	240	Xhevdet Thaqi, Nervije Ismaili, Bajram Kosumi
3	Juridik i Përgjithshëm	LLB	240	Dukagjin Leka, Sadik Haxhiu, Feti Limani
4	Menaxhment	BA	180	Gëzim Tosuni, Naim Mustafa, Musa Ajeti
5	Shkenca Kompjuterike	BSc	180	Basri Ahmeti, Ekrem Alimi, Ragmi Mustafa

AKA ka organizuar dy vizita në Universitetin të Gjilanit “Kadri Zeka”. Vizita e parë është realizuar me 10.05.2016, me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Prof. Dr. Kristiina Tonnisson, Prof. Dr. Erwin Bratengeyer, Prof. Dr. Josep Maria Duarte. Vizita e dytë është realizuar me 10.06.2016, me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Prof. Dr. Peter Parycek, Prof. Dr. Ksenija Grubišić.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 06 Korrik 2016 ka vlerësuar aplikacionin e Universitetit të Gjilanit “Kadri Zeka”, dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportin final nga ekspertët e cekur më sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 126, pika 2 a, të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet këtij organi në afatin prej 30 ditëve siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Vendimi iu dërgohet:

- Universitetit të Gjilanit “Kadri Zeka”;
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.

Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë